



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1758 Prot.

Lezhë, më 05.02. 2021

VENDIM

Nr 18, Datë 04 / 02 / 2021

**“PËR
PËRCAKTIMIN E VLERAVE PËR PËRFITUESIT E GRANTIT TË RINDËRTIMIT,
BANESAT E TË CILËVE JANË KLASIFIKUAR NGA AKTEKSPERTIZAT E
THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT ME NIVEL DËMESH DS4 DHE DS5
DHE DUHET TË RINDERTOHEM NGA E PARA”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, vendimit nr. 887, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI :

1. Përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga Aktekspertizat e thelluara të Insitutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS4 dhe DS5 për rindërtim nga e para, sipas tabelës së mëposhtme:

Përbërja familjare	Struktura e banesës individuale	Vlera e grantit të rindërtimit
Deri në 2 anëtarë	1+1	2,236,552 (dy milion e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e peseqind e pesedhjetë e dy) lekë
2 deri në 4 anëtarë	2+1	2,613,358 (dy milion e gjashtëqind e trembedhjetë mijë e treqind e pesedhjetë e tete) lekë
5 e më shumë anëtarë	3+1	3,424,758 (tre milion e katerqind e njetete e kater mijë e shtateqind e pesedhjetë e tete) lekë

2. Bashkia Lezhë paraqet për miratim në Këshillin Bashkiak listen e përfituesve dhe masat e përfitimit dhe pas miratimit të listes nga Këshilli Bashkiak midis Bashkisë dhe Subjektit përfitues lidhet kontrata e përfitimit të grantit të rindërtimit.
3. Shuma e grantit të rindërtimit shpërndahet në dy këste: kësti i parë, në masën 60 % të vlerës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës depozitohet në llogarinë e Postës Shqiptare. Pjesa e mbetur e shumës, për grantin e rindërtimit lëvrohet pas verifikimit nga struktura përkatëse e mbikqyrjes së kontratës që subjekti përfitues ka përfunduar ndërtimin e karabinasë së objektit në përputhje me dokumentet e lejes së ndërtimit.
4. Miratimin e kontratës tip për përfitimin nga granti i rindërtimit për individët ose familjet, sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, e cila përmban minimalisht elementët si: afatet që parashikohen në lejet përkatëse të ndërtimit si dhe penalitetet në rastet e mospërmbyshjes së detyrimit, që përfshijnë por nuk kufizohen edhe në kthimin e grantit kur konstatohen abuzime nga përfituesi, sipas parashikimeve të legjisllacionit në fuqi për këto kontrata.
5. Kryetari i Bashkisë dhe Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ndjekin procedurat e përshpejtuara për shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi, sipas parashikimeve të vendimit nr. 887, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave.
6. Mbikqyrja e zbatimit të kontratës nga përfituesi të kryhet nga strukturat përkatëse të përcaktuara me urdhër të kryetarit të Bashkisë Lezhë. Struktura e mbikqyrjes së zbatimit të kontratës së grantit përmbush ato funksione që ngarkohen në urdhrin e kryetarit dhe kontratën e grantit.
7. Ngarkohet kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij, për nënshkrimin e kontratës përkatëse të grantit, e cila përmban minimalisht parashikimet e modelit tip, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Emergjencave Civile, Drejtoria e Sherbimit dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Sherbimeve Publike, Infrastruktues dhe Mjedisit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, Drejtoria e Finances dhe Buxhetit, njësitë administrative të Bashkisë Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
ERNEST RAKAJ

